



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSh

■ Gjatë muajit tetor është bërë monitorimi i 300 mësimdhënësve, të cilët janë duke përcjellë trajnimin “Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit”. Këta mësimdhënës kanë filluar trajnimin në muajin qershor dhe deri në fund të shtatorit kanë përfunduar tri seminare. Për të vlerësuar performancën e mësimdhënësve në zbatimin e teknikave dhe strategjive të mësuara, trajnerët kanë bërë monitorimin e secilit mësimdhënës të përfshirë në trajnim dhe rezultatet e monitorimit i kanë prezantuar në takimin gjysmëditor që është mbajtur më 27 tetor 2007 në 10 qendra të Kosovës, në Prishtinë (2 grupe), në Prizren (2 grupe), Gjakovë, Drenas, Shtime, Mitrovicë, Gjilan dhe Klinë. Raportet nga trajnerët tregojnë që mësimdhënësit kanë filluar të kuptojnë filozofinë e programit të MKLSh-së dhe me përkushtim janë duke i zbatuar teknikat dhe strategjitë në klasat e tyre. Mësimdhënësit janë njoftuar se seminari i katërt për të gjitha grupet do të mbahet më 10-11 nëntor 2007.

■ Më 20-21 tetor 2007, MASHT në bashkëpunim me KEC kanë filluar trajnimin e 19 grupeve të mësimdhënësve në kuadër të programit të MKLSh-së. Grupet me nga 30-32 mësimdhënës janë formuar në Prishtinë, Hajvali, Podujevë, Mitrovicë, Vushtri, Skënderaj, Pejë, Junik, Glllogjan, Malishevë, Krushë e Madhe, Prizren, Suharekë, Dragash, Kaçanik, Feriza, Shtime, Viti dhe Gjilan. Përzgjedhja e mësimdhënësve është bërë nga Zyrat Rajonale të Arsimit. Trajnimet kanë filluar në kohë dhe gjatë seminarit

të parë është prezantuar moduli “Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë kurrikulumit”. Raportet nga trajnerët tregojnë se çdo gjë është zhvilluar sipas dinamikës së paraparë. Seminari i dytë për këta mësimdhënës do të mbahet më 24-25 nëntor 2007.

■ Gjatë muajit tetor është bërë dhe monitorimi i mësimdhënësve të shkollave “M. Këpuska”, “F. Agani”, “Zekerija Rexha” dhe “Zef Lush Marku” të Gjakovës. Raportet nga monitorimi tregojnë se mësimdhënësit kanë zbatuar në mënyrë të shkëlqyer teknikat dhe strategjitë e programit të MKLSh-së në klasat e tyre. Seminari i fundit për këta mësimdhënës do të mbahet më 3-4 nëntor me ç’rast do të bëhet dhe certifikimi i tyre.

Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin

■ Më 2-3 tetor 2007 në sallën e Kuvendit Komunal në Malishevë është mbajtur seminari “Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin”. Në këtë seminar morrin pjesë 22 përfaqësues të Kuvendit Komunal të Malishevës, drejtorë të shkollave, si dhe përfaqësues të OJQ dhe mediave. Seminari zgjoi interesimin e pjesëmarrësve për të diskutuar rreth dukurive korruptive që ata i hasin gjatë jetës së tyre të përditshme. Pjesëmarrësit ishin shumë konstruktiv, gjë e cila bëri që seminari të zhvillohet në një atmosferë shumë të mirë.

■ Gjatë muajit tetor në kuadër të projektit të ATRC janë mbajtur dhe 6 tryeza të rrumbullakëta në 6 qytete të ndryshme të Kosovës. Tryezat e rrumbullakëta kishin për qëllim që të ofrojnë mundësinë që

qytetarët të diskutojnë për korrupsionin dhe strategjitë anti-korrupsion duke e shqyrtuar atë nga aspekte të ndryshme.

Titujt e tryezave të rrumbullakëta sipas komunave janë:

- Edukimi, strategjia më efiçase për parandalimin e korrupsionit e cila u mbajt në Vushtrri më 5 tetor 2007
- Roli i të rinjve në luftimin e korrupsionit, e cila u mbajt në Pejë më 9 tetor 2007
- Bashkëpunimi i qytetarëve me SHPK për të luftuar korrupsionin, që u mbajt në Istog më 9 tetor 2007
- Shtimi i transparencës redukton korrupsionin u mbajt në Gjilan më 9 tetor 2007
- Bashkëpunimi i institucioneve, OJQ dhe qytetarëve për të luftuar korrupsionin u mbajt në Prishtinë më 23 tetor 2007
- Praktikë korruptive në Mjekësinë Familjare dhe etika e mjekut e cila u mbajt në Prizren më 29 tetor 2007.

Të gjitha tryezat e rrumbullakëta janë përcjellë nga mediat lokale, ndërsa në Prishtinë tryeza është prezantuar dhe në lajmet qendrore të KTV. Debati i zhvilluar në tryezë të rrumbullakët në Prishtinë ka motivuar gazetarët e KTV që të prezantojnë tryezën dhe të iniciojnë për shikuesit pjesëmarrje me përgjigje në pyetjen "Sa luftohet korrupsioni në Kosovë". Tri përgjigjet më të mira të qytetarëve janë prezantuar në lajmet e orës 23.00. Ky program trajnimi ka përfunduar më 30 tetor 2007.

Edukimi për të Drejtat e Fëmijës

■ Me datën 1 tetor 2007, është organizuar një aktivitet me nxënësit e shkollës jopublike "Mileniumi i Tretë". Siç dihet, 1 Tetori është Dita Ndërkombëtare e njerëzve të moshuar. Për nder të kësaj dite nxënësit e kësaj shkolle bënë një vizitë në Shtëpinë e Pleqve, në Prishtinë. Ata kishin përgatitur një program me disa këngë e vjersha, të cilat i interpretuan para njerëzve të moshuar. Po ashtu, përveç shfaqjes fëmijët kishin përgatitur edhe disa dhurata të, enkas për të moshuarit, të cilat iu dhuruan atyre.



Edukimi Multikulturor dhe Multietnik

■ Programi zhvillohet sipas dinamikës së projektit. Edhe në këtë cikël, është vazhduar me trajnimin e mësimeve dhe aktivitetet sociale.

Trajnimet treditore janë mbajtur në Ferizaj si dhe në Prizren katër grupe. Certifikimi i pjesëmarrësve të këtyre grupeve do të bëhet gjatë muajit nëntor të këtij viti.

Aktivitetet sociale, po ashtu janë duke u bërë sipas dinamikës së projektit. Këtë muaj janë mbajtur 5 aktivitete sociale.

Aktiviteti social në Prishtinë: është organizuar në Gërmi. Pjesëmarrës në këtë

aktivitet ishin: 15 nxënës nga shkolla speciale "Përparimi", 5 nxënës të komunitetit boshnjak nga shkolla fillore "Naim Frashëri" dhe 5 nxënës të komunitetit turk nga shkolla fillore "Elena Gjika".



Aktiviteti social në Prizren: është organizuar me fëmijët e grupmoshës 12 vjeçe nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Prizren: 9 fëmijë të komunitetit rom, 7 fëmijë të komunitetit turk, 7 fëmijë boshnjak dhe 7 shqiptarë. Aktiviteti është mbajtur në sallën e Qendrës së komuniteteve dhe më pas në pushimoren e Marashit.

Aktiviteti social në Ferizaj: është organizuar me një numër më të madh të fëmijëve. Fillimisht është bërë vizitë në shpellën e Gadimes e më pas aktivitetet sociale kanë vazhduar në lokalet e Qendrës Didaktike, në Ferizaj. Pjesëmarrës ishin nxënësit e disa shkollave fillore të Ferizajt, nxënës të komuniteteve të ndryshme dhe disa nxënës nga shkolla fillore "Hasan Prishtina" në Prishtinë.



Aktiviteti social në Pejë: Peja ishte vendi, ku ky aktivitet u zhvillua pak më ndryshe se në vendet tjera. Meqë 31 tetori është festa e ashtuquajtur "Nata e shtrigave", Peja këtë aktivitet e organizoi me një "Festë maskash" (maskenball).

Pjesëmarrës ishin fëmijë të komuniteteve të ndryshme. Aktivitetet sociale, fëmijët i zhvilluan të veshur në mënyra të ndryshme. Në fund u bë edhe përzgjedhja e maskave më të bukura dhe fëmijët fitues u shpërblyen me nga një dhuratë.

Fëmijët e maskuar, bënë një vizitë edhe në TMK ku u njohën më afër me rregullat dhe punën e bërë nga pjesëtarët e TMK-së.

Hap pas Hapi

■ Me datat 8-10 në lokale e KEC u mbajt për herë të parë trajnimi Edukimi për të drejtën shoqërore - për fëmijë.

Këtë trajnim e udhëhoqi trajneri nga Sllovakia Peter Repisky. Në trajnim morën pjesë 23 Pjesëmarrës.

Të gjitha njohuritë dhe aktivitetet që janë shpërndarë gjatë këtyre tri ditëve janë të dizajnuara në atë mënyrë, që të gjithë pjesëmarrësit, pra, mësime të kenë mundësi t'i përdorin në klasë.



Në bazë të vlerësimeve nga pjesëmarrësit u vërtetua se ky lloj trajnimi është shumë i mirëseardhur për mësime të tanë.

■ Me datën 17 tetor u mbajt punëtorja "Si të krijohet dosja e mësime të cilët punojnë me metodologjinë Hap pas Hapi". Këtë punëtori e mbajti Sanja Gena-Haxhar nga Bosnja dhe Hercegovina. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin monitorët e

programit Hap pas Hapi të cilët së shpejti, informatat e fituara në këtë punëtori do të ia përcjellin mësimdhënësve të shkollave fillore dhe edukatorëve të institucioneve parashkollore.

■ Në Mitrovicë me 18 tetor u mbajt takimi i parë për këtë vit shkollor me "Kontakt personat" e Institucioneve parashkollore. Në këtë takim u paraqit nevoja të mbahet një punëtori për planifikim. U caktua që me datën 15 nëntor në zyrat e KEC të organizohet punëtorja ku do të marrin pjesë edhe disa drejtor dhe pedagog të institucioneve parashkollore.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Në kuadër të projektit "Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim", nga data 6 deri më 8 nëntor 2007, në Hotel "OK" (magjistralja Prishtinë-Prizren, në hyrje të Prizrenit) do të mbahet trajnimi Hartimi i politikave.

Ky trajnim është ndër segmentet më të rëndësishëm të këtij projekti. Trajnimit do ta udhëheq trajnerja nga Hungaria Katalin Pallai.

Edukimi për të drejtën shoqërore

■ Gjatë muajit tetor, përkatësisht me datat 5, 6 dhe 7 në Prishtinë është mbajtur trajnimi treditor Edukimi për të Drejtën Shoqërore Moduli II, organizuar nga Qendra për Arsim e Kosovës. Në këtë trajnim morën pjesë mësimdhënës të arsimit fillor dhe të mesëm, përfaqësues të shoqërisë civile, studentë të cilët më parë kanë përfunduar

trajnimin Edukimi për të Drejtën Shoqërore, Moduli I.

Pjesëmarrësve iu është prezantuar programi i trajnimit, që ka për synim ngritjen e njohurive për paragjykimet, stereotipet, shtypjet dhe format e shtypjes, mënyrën e krijimit të tyre si dhe strategjitë për ndryshim të qëndrimeve dhe sjelljeve, të cilat janë krijuar ndaj individëve dhe grupeve tjera. Trajnimi u mbajt në lokalet e KEC, dhe gjatë gjithë kohës është mentoruar nga trajneri nga Slovakia Peter Repisky.



■ Programi "Edukimi për të Drejtën Shoqërore" i financuar nga Banka Botërore është duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit.

Trajnimet e mësimdhënësve kanë mbaruar ndërsa muaji tetor ishte muaji kur edhe filluan aktivitetet sociale në kuadër të këtij projekti. Gjithsej janë mbajtur 4 aktivitete sociale.

Aktiviteti social në Gjakovë: është organizuar me nxënësit e shkollës fillore "Zekerija Rexha" në Gjakovë. Ky aktivitet në Gjakovë u bë në trajtën e orës letrare me temën "*Lumturia e fëmijëve shihet në sytë e tyre*" dhe "*Barazia në vendin tonë*". Nga pjesëmarrësit u lexuan gjithsej 20 punime të nxënësve dhe katër prej tyre u shpërblyen. Nxënësit fitues janë: Feride Kurti, Blerand Bellaja, Natyra Xharavina dhe Rina Brovina.

Aktiviteti social në Prizren: është organizuar më fëmijët e të gjitha komuniteteve të cilët jetojnë në Prizren. Është mbajtur një tryezë e rrumbullaket ku të gjithë fëmijët shprehën mendimet e tyre për të drejtat e tyre, si dhe rreth temës se sa respektohet këto të drejta në shoqëri, respektivisht në Prizren. Po ashtu, këta fëmijë kanë vizituar edhe muzeun historik të Lidhjes së Prizrenit.



Aktiviteti social në Lipjan: është mbajtur një workshop (punëtori) me fëmijët e Shtëpisë Korrektuese, në Lipjan. Kjo punëtori kishte për qëllim risocializimin e fëmijëve të komuniteteve të ndryshme. Të miturit në këtë qendër, u ndanë shumë të kënaqur dhe me shpresë se edhe në të ardhmen do të kemi raste të organizojmë aktivitete të tilla të cilat janë më se të nevojshme për zhvillimin e tyre të mëtutjeshëm.

Aktiviteti social në Pejë: u organizua një debat në lokalet e Qendrës Didaktike. Në këtë debat morën pjesë 30 nxënës të komuniteteve të ndryshme e po ashtu edhe të shkollave dhe vendeve të ndryshme të asaj komune. Ishin nxënës nga shkollat e Pejës, Istogut, Deçanit dhe Klinës. Të gjithë nxënësit ishin të përcjellur nga Drejtorët e shkollave përkatëse dhe mësimdhënësit të cilët ishin pjesëmarrës në trajnimin "Edukimi për të Drejtën Shoqërore".


Access Microscholarship Program

■ Në kuadër të këtij projekti vazhdojnë aktivitetet. Edhe pse në fillim të këtij semestri janë paraqitur mjaft shumë probleme për shkak të orarit të papërshtatshëm të disa fëmijëve për ndjekjen e këtij kursi. Orët mësimore po mbahen ashtu si edhe janë planifikuar për të tri grupet, në Prishtinë dhe Prizren. Mendohet që në kuadër të këtij projekti të organizohet një aktivitet social gjatë muajit nëntor të këtij viti.

Promovimi i librit STUDIMI AKADEMIK

■ Me datën 3 tetor, në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare u bë promovimi i librit Studimi Akademik. Këtë libër tashmë mund ta kenë në dorë studentët dhe profesorët universitarë, falë angazhimit dhe përkushtimit maksimal të Qendrës për Arsim të Kosovës në Prishtinë dhe Qendrës për Arsim Demokratik në Tiranë, të cilët edhe janë botues të këtij libri.

Libri në fjalë është pjesë e serisë së botimeve për Zhvillimin e të menduarit kritik në arsimin e lartë dhe si i tillë është një udhëzues i strategjive të leximit dhe studimit shkencor që i ka munguar prej kohësh studiuesit tonë.



"Studimi Akademik", është libër model me vlera të pakontestueshme në fushën e studimeve akademike, ndaj edhe vlerësimet për të janë dhe duhet të jenë pjesë e zhvillimeve tona kulturore dhe arsimore.

Përgatiti: Petrit Tahiri